



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:189815
Datë: 24.04.2024
Numri i dokumentit: 05611524

K.Dh.Shk.II.nr.338/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, gjyqtari Ramush Bardiqi, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A, me NUI:810547549 me seli në rr. “Hazir Shala” nr.4, në Prishtinë, ndaj debitorit PECB Group Inc Branch in Kosovo, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1398/23 të datës 27.10.2023, me datë 23.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e kreditorit Kompania Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.1398/23 i datës 27.10.2023, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykatës Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1398/23 i datës 27.10.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit PECB Group Inc Branch in Kosovo – Dega e Shoqërisë së Huaj, me seli në Prishtinë, dhe ka shfuqizuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.301/2023, të datës 08.08.2023, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Fadil Hoxha.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë kreditori Kompania Regjionale Ujësjiellësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës civile dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozimin që të aprovohet ankesa si e bazuar, të prishet

aktvendimi i kundërshtuar dhe çështja t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim – rivendosje ose të ndryshohet aktvendimi i kundërshtuar.

Në përgjigjen në ankesë të datës 23.01.2024 debitori, ka kundërshtuar ankesën e kreditorit dhe ka kërkuar nga gjykata që të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhomat e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (LPP), si dhe në kuptim të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

- Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Regjionale Ujësjellësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, me datën 08.08.2023 ka paraqitur propozim për lejimin e përmbartimit, kundër debitorit PECB Group Inc Branch in Kosovo, me seli në Prishtinë, në bazë të dokumentit të besueshëm – ekstrakti nga Librat e Afariste me shifër 115458.

Përmbartuesi Privat Fadi Hoxha, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Kompania Regjionale Ujësjellësi “Prishtina” Sh.A, me seli në Prishtinë, ka caktuar urdhrin P.nr.301/2023 të datës 08.08.2023 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm , përkatësisht ekstrakti nga Librat e Kontabilitetit me shifër 115458, me të cilin e ka urdhëruar debitorin, që të ia paguaj kreditorit në emër të borxhit të përcaktuar në shumën prej 761.63€, si dhe shpenzimet e përmbartimit sipas tarifës së Përmbartuesve Privat në pajtim me Udhëzimin Administrativ nr.01/2022 për shpërblimet dhe kompensimin e shpenzimeve për Përmbartuesit Privat.

Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1398/23 të datës 27.10.2023 me të cilin e ka pranuar si të bazuar prapësimin e PECB Group Inc Branch in Kosovo – Degë e Shoqërisë së Huaj dhe e ka shfuqizuar urdhrin përmbartimor P.nr.301/2023, të datës 08.08.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Fdil Hoxha.

Në arsyetim të aktvenë atakuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se Në vlerësimin e gjykatës, vetëm përshkrimi i debitorit “PECB Group Inc Branch In Kosovo, M.H.,” pa treguar saktë debitorin, nuk është e mjaftueshme për identifikimin e debitorit të përmbartimit, sidomos për faktin se në rastin konkret, rezulton se palët e lartpërmendura nuk kanë ndërlidhje me njëra tjetrën, konkretisht pala “PECB Group Inc Branch In Kosovo, rezulton të ketë qenë shfrytëzues i lokalit në cilësinë e qiramarrësit, ndërsa pala M.H. paraqitet si qiradhënës i lokalit në fjalë. Andaj, si rezultat i këtyre të metave, propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet nga neni 38 i LPP-së. Sipas nenit 43, par. 4 të LPP-së, përcaktohet se *“Në lidhje me ankesën që ngrehtë kundërshtimin ndaj urdhrin të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrin për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon*

urdhri me vendim”. Nisur nga kjo dispozitë, gjykata gjen se në rastin konkret urdhri mbi lejimin e përmbarimit është nxjerrë pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij, ngase në propozim për përmbarim nuk janë paraqitur të dhënat e nevojshme për identifikimin e debitorit dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarim përmban të meta në kuptim të nenit 38, paragrafi 1 të LPP-së. Meqenëse këto të meta nuk mund të evitohen në këtë fazë të procedurës, sepse gjykata në fazën e procedurës sipas mjetit juridik, kufizohet vetëm në shqyrtimin e përshtatshmërisë së dokumentit mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri si dhe ligjshmërinë e urdhrit, rezulton se urdhri përmbarimor është nxjerr pa u plotësuar kushtet për lejimin e tij.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të Gjykatës së Shkallës së Parë, Gjykata Komerciale e Kosovës – Dhomat e Shkallës së Dytë, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se Gjykata e Shkallës së Parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore me rastin e vendosjes për aprovim të prapësimi të debitorit. Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, Dhomat e Shkallës së Parë drejtë kanë vlerësuar gjendjen faktike kur kanë konstatuar se sipas nenit 38, paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, *“Propozimi për përmbarim duhet ta përmbajë kërkesën për përmbarim në të cilën do të tregohet dokumenti përmbarimor origjinal apo kopje e vërtetuar, apo dokumenti i besueshëm në bazë të cilit kërkohet përmbarimi, kërkuesi i përmbarimit dhe debitori, adresa e vendbanimit - vendqëndrimin apo selisë afariste të kreditorit dhe të debitorit, kredia që kërkohet të realizohet, si dhe mjete nëpërmjet të cilëve duhet kryer përmbarimi, objekti i përmbarimit po qe se është i njohur, si dhe të dhënat e tjera që janë të nevojshme për zbatimin e përmbarimit. 2. Në rast se propozimi për përmbarim nga paragrafi 1. i këtij neni nuk përmban shënimet e kërkuara dhe numrin personal identifikues apo numrin e regjistrimit të biznesit të debitorit, organi përmbarues do të veprojë sipas dispozitave të nenit 102 të Ligjit të Procedurës Kontestimore.”* Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cekura si më lartë, gjeti se urdhri mbi lejimin e përmbarimit është lejuar në kundërshtim me dispozitën nga neni 38, paragrafi 1, ngase në propozim për përmbarim kreditori nuk ka paraqitur të dhëna e nevojshme në drejtim të identifikimit të debitorit, përkatësisht propozimi për përmbarim është ushtruar ndaj “PECB Group Inc Branch In Kosovo M.H.”, duke mos treguar qartë debitorin, dhe të dhënat e tjera të nevojshme për identifikimin e debitorit. Nga regjistri publik i ARBK-së për numrin fiskal 601513220 të paraqitur në propozimin për përmbarim emri i biznesit rezulton se është “PECB Group Inc Branch In Kosovo Dega në Kosovë”, me pronar “Pecb group inc”. Andaj në rastin konkret nuk dihet se propozimi për përmbarim a drejtohet për subjektin PECB Group Inc Branch In Kosovo Dega në Kosovë, apo për palën M.H., apo kemi të bëjmë me debitor solidar.

Mbi bazën e kësaj dispozite ligjore, kjo Gjykatë vlerëson se Dhomat e Shkallës së Parë kanë konstatuar drejtë se Ekstraktit nga librat e kontabilitetit si dokument i besueshëm mbi të cilën ishte iniciuar procedura përmbarimore, respektivisht është lejuar përmbarimi nuk i plotëson

kushtet në mënyrë komulative qe duhet t'i ketë dokumenti i besueshëm, ashtu që propozimi për përmbarrim nuk i plotëson kushtet nga Neni 38 i LPP-së.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti se procedura përmbarrimore paraqet procedurë formale që i nënshtrohet shqyrtimit formal të dokumenteve përmbarrimore dhe/apo atyre të besueshme, rrjedh se si kusht esencial mbi bazën e së cilës mund të lejohet përmbarrimi janë tiparet e përmbarrueshmërisë së dokumentit të besueshëm e të cilit në rastin konkret i mungojnë kushtet nga Neni 38 i LPP-së. Së këndejmi, Gjykata thekson se pa plotësimin e këtij kushti dokumenti i besueshëm nuk mund ta ketë fuqinë e titullit përmbarrues sepse rezulton se nuk janë paraqitur të dhëna të nevojshme për identifikimin e debitorit dhe rrjedhimisht propozimi për përmbarrim përmban të meta në kuptim të nenit v38 paragrafi 1 të LPP-së.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pa bazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, dhe zbatimin të gabuar të drejtës materiale, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 pika b) të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e shkallës së dytë
K.Dh.Shk.II.nr.338/24 dt.23.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi